

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Nr. 02-52/13-07

Prishtinë, më 10 maj 2007, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 77 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 27 prillit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shoqëritë tregtare,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse,
6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për shpenzimet e vitit 2006,
7. Debat për arsimin fillor dhe të mesmin,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës,
9. Shqyrtimi i Propozimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për formimin e Këshillit të Ujërave,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për t'ia kthyer Qeverisë së Kosovës Projektligjin për ndërmjetësim për ripunim.

Në fillim të seancës, **kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit për formimin e Grupit të ri Parlamentar të LDD-së.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kuvendi, pas diskutimit të disa deputetëve, me shumicë votash, miratoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesia e Kuvendit.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 27 prillit 2007

Procesverbali i seancës plenare të 27 prillit 2007 u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Naxhije Doçi** i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencë dhe Teknologjisë lidhur me përfshirjen e fëmijëve në paralelet parashkollore.

Ministri **Agim Veliu** iu përgjigj pyetjes së deputetes Doçi.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtroi pyetje ministrit të Drejtësisë lidhur me aplikimin e ligjeve të Serbisë në Kosovë.

Ministri **Jonuz Salihaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kelmendi.

Deputeti **Bajrush Xhemajli** i parashtroi një pyetje ministrit **Sadik Idriz** dhe dy pyetje ministrit **Qemajl Ahmeti**, por ata nuk ishin të pranishëm në seancë. Përgjigjet mbasin për seancën e radhës.

Deputetja **Zyhrije Maloku** i parashtroi pyetje zëvendësministrit të Bujqësisë lidhur me sëmundjen e shpendve.

Zëvendësministri **Tomë Hajdaraj** iu përgjigj pyetjes së deputetes Maloku.

Deputeti **Genc Gorani** i parashtroi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë lidhur me dhënien e lejeve për tregtinë e brendshme.

Ministri **Bujar Dugolli** iu përgjigj pyetjes së deputetit Gorani.

Deputeti **Nazim Jashari** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me inkasimin e mjeteve nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës.

Ministri **Haki Shatri** iu përgjigj pyetjes së deputetit Jashari.

Deputetja **Nurishahe Hulaj** i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me suksesin dhe sigurinë në mjediset shkollore.

Ministri **Agim Veliu** tha se do të përgjigjet në seancën e ardhshme.

Deputetja **Qibrije Hoxha** i parashtoi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë lidhur me shitjen e NP “Ramiz Sadiku” dhe pagesën e 20% punëtorëve të ndërmarrjes.

Ministri **Bujar Dugolli** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hoxha.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtoi pyetje zëvendësministrit të Bujqësisë lidhur me shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore.

Zëvendësministri **Tomë Hajdaraj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me falsifikimin e diplomave.

Ministri **Agim Veliu** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shoqëritë tregtare

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Tregtisë dhe i Industrisë, z. **Bujar Dugolli**, në emër të Qeverisë së Kosovës arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim ministri **Dugolli** arsyetoi materien e radhitur në tetë kapituj dhe në 236 nene, objektivat, strukturën e Projektligjit, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Dugolli**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Brikenda Kryesziu**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Sala Berisha-Shala**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Xhevdet Neziraj**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Nazim Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi**, në emër të Grupit Parlamentar 6 plus, **Mahir Yagcilar** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim **Vezira Emrush**.

Në diskutim morën pjesë edhe këta deputetë: **Bajrush Xhemajli**, **Ibush Jonuzi**, **Milazim Haliti** dhe **Behxhet Brajshori**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 73;

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në parim Projektligjin për shoqëritë tregtare.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t’ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7,8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24 dhe 25.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----72;

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse.

Kryetari dha pauzë për drekë.

6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për shpenzimet e vitit 2006

Kryetari e ftoi ministrin e Ekonomisë dhe të Financave ta arsyetonte raportin financiar për vitin 2006 para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Haki Shatri** – Raporti i ofruar për diskutim ofron të gjitha informacionet, që i parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave angazhimin e vet gjatë vitit 2006 e ka fokusuar në sigurimin dhe me forcimin e stabilitetit dhe të qëndrueshmërisë buxhetore, si njëra ndër kushtet bazë për funksionimin normal të institucioneve shtetërore.

Në këtë vit vendimtar këtë detyrë të rëndësishme dhe të komplikuar e kemi kryer me shumë sukses, që është vlerësuar edhe nga institucionet kompetente ndërkombëtare, që na mbështesin, monitorojnë dhe raportojnë për proceset buxhetore në Kosovë.

Këto rezultate janë arritur duke u përqendruar në dy kahe të aktiviteteve: Së pari, duke e ngritur efektivitetin në vjeljen e të hyrave dhe në anën tjetër duke e kontrolluar rigorozisht rrjedhën e shpenzimeve.

Të hyrat e parapara me buxhet në shumë prej 656 milion € **janë tejkaluar për 8.5% ose për 56 milion €**, që do të thotë janë realizuar 712 milion euro të hyra në vitin buxhetor 2006.

Të hyrat në kufi, që grumbullohen nga doganat, janë 456 milion € ose 7 % mbi planin e paraparë me buxhet.

Administrata Tatimore e Kosovës ka inkasuar 30% më shumë të hyra se sa ishte e përcaktuar me buxhet për vitin 2006. Në vend të 126 milion euro ka grumbulluar 164 milion euro.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2006, që kanë qenë të parapara 727 milion €, nga të cilat 28 % për paga dhe mëditje, 162 milion për mallra dhe shërbime komunale, 163 milion për transferet sociale dhe 190 milion për investime kapitale.

Shpenzimet gjatë vitit kanë qenë për **90 milion nën shpenzimet e lejuara me buxhet**.

Janë kursyer 33 milion e 180 mijë € dhe janë rezultat i mbikëqyrjes së procesit të shpenzimeve në MEF dhe si rezultat i kujdesit të shtuar të organizatave buxhetore.

Për paga janë shpenzuar vetëm 203 milion nga 209 sa ishin të parapara. Për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 124 milion dhe janë kursyer 17.7 milion. Për shërbimet komunale janë kursyer afër 2 milion € dhe subvencionet dhe transferet kanë kursyer 8 milion €. Pra, janë kursyer gjithsejt 33 milion €.

Ana tjetër e shpenzimeve e proceseve buxhetore është më e dobët, sepse nuk janë realizuar shpenzimet për investime kapitale, që do të ishte shumë e dobishme po të realizoheshin sipas dinamikës së paraparë. Nga 180 milion euro të lejuara në buxhet për investime janë realizuar vetëm 133 milion euro, ose rreth 57 milion më pak. Njëra ndër pengesat kryesore ishin procedurat e prokurimit. MEF-i ka aplikuar një metodë të re, në procedura buxhetore, me të cilën organizatave buxhetore u mundësohet vazhdimi i realizimit të programeve për investime në vitin vijues buxhetor.

Shpenzimet buxhetore janë pasqyruar, po ashtu, edhe sipas funksionit dhe klasifikimit të aktivitetit ekonomik.

Rezultatet e arritura në vitin 2006 dhe vlerësimet pozitive të proceseve buxhetore ia kanë hapur rrugën Kosovës që menjëherë pas zgjidhjes së statusit të organozohet një Konferencë e madhe me donatorë, që do të sponsorizohet nga Këshilli i Evropës dhe nga Banka Botërore.

Sipas të gjitha indikacioneve Kosovës do t'i ofrohet mbështetje e madhe buxhetore për investime kapitale.

Pas fjalës së ministrit Shatri, **kryetari** e hapi debatin për shqyrtimin e Raportit për shpenzimet e vitit 2006.

Në emër të grupeve parlamentare diskutuan: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së **Behxhet Brajshori**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Nazim Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi**, në emër të Grupit Parlamentar për Integritim, **Ferid Agani** dhe në emër të Grupit Parlamentar 6 plus, **Rifat Krasniq**, si dhe deputetët: **Safete Hadërgjonaj**, **Teuta Hadri**, **Gani Koci**, **Enver Hoxhaj**, **Shaban Halimi**, **Bajram Kosumi**, **Bujar Dugolli**, **Hydajet Hyseni**, **Sala Berisha**, **Fehmi Mujota**, **Selvije Halimi**, **Fatmire Mulhaxha**, **Xhevat Bislimi** dhe **Sabri Hamiti**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Në fund të debatit, ministri **Haki Shatri** iu përgjigj vërejtjeve dhe pyetjeve të deputetëve.

Pastaj, **kryesuesi** e hodhi në votim Raportin financiar të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për shpenzimet e vitit 2006. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----45;
Kundër----- 22;
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Raportin financiar të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për shpenzimet e vitit 2006.

Kryesuesi seancën e sotme e deklaroi të mbyllur në orën 17:00 për t'i vazhduar punimet nesër në orën 10:00.

E premte, 11 maj 2007

Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i kryesisë së Kuvendit.

Të pranishëm shin 82 deputetë.

7. Debat për arsimin fillor dhe të mesëm

Kryetari e ftoi parashtruesin e mocionit ta merrte fjalën.

Deputeti **Enver Hoxhaj**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e arsyetoi nevojën për të debatuar për gjendjen në arsimin fillor dhe të mesëm, duke e vlerësuar se gjendja kurrë nuk ka qenë më shqetësuese dhe më e rëndë se sa këto tri vitet e fundit.

Kjo gjendje është pasoja e saj se sistemi i arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë ka funksionuar këto tri vite të fundit sikurse Kosova të mos kishte fare Qeveri dhe Ministri të Arsimit.

Informatën që e ka përgatitur Ministria e Arsimit është shumë selektive.

Deri më tash kam takuar në 17 qytetet e Kosovës prind, arsimtarë, nxënës, të cilët e përshkruajnë gjendjen në arsim si shumë alarmante.

Unë e kam ndërmend vetëm t'i prezantoj 5 probleme kyçe, që e përcjellin arsimin në Kosovë.

Problemi i parë, ka të bëjë me hapësirën shkollore. Hapësira shkollore në Kosovë jo vetëm që është e vogël, por është edhe në zvogëlim e sipër. Mësimi në shkolla fillore dhe të mesme zhvillohet me tri, katër ndërrime ,që ora zgjatë 20 ose 25 minuta, që në një bankë ulen 2 deri në 3 nxënës.

Problemi i dytë, ka të bëjë me cilësinë e arsimit, me nivelin e diturisë, me atë se çfarë i afrohet nxënësve- çka fiton nxënësi. Tekstet shkollore shkruhen nga gjysma e punëtorëve që punojnë në Ministri të Arsimit dhe nga gjysma e të tjerëve, të cilët janë të preferuarit e tyre, që nuk kanë autoritet shkencor dhe kulturor. Recensionet nuk merren fare parasysh.

Ka shumë shkolla që vitin e kaluar i kanë marrë librat në dhjetor, disa prej tyre në janar. Është krijuar një anarki, që i shërben vetëm grupit të caktuara të interesit.

Problemi i tretë, është sukseksi i nxënësve që në gjysmë vjetorin e parë të vitit shkollor 2005/2006, sipas analizës së vet Ministrisë, në arsimin fillor deri në klasën e pestë rezultatet janë pozitive, kurse në arsimin e ulët, të mesëm dhe në arsimin e lartë rezultatet janë negative.

Rezultati i tekstit kombëtar, sipas raportit të Ministrisë, tregon se kanë kaluar pragun prej 40%.

Pjesë kryesore e këtij dështimi është mosimplementimi i Kornizës korikorale në shkollat fillore dhe të mesme. Ky është njëri prej dokumenteve më të mira që ka Kosova, që është hartuar në bashkëpunim me UNICEF-in.

Ministria e Arsimit, para disa javësh ka bërë një strategji për arsimin para universitar, i cili fare nuk i referohet nevojave të tregut të punës.

Shkollat fillore dhe të mesme funksionojnë në një formë ku komunikimi mes shkollës fillore, drejtori për arsim në komuna, Ministrisë së Arsimit nuk funksionon. Përveç kësaj, përzgjedhja e kuadrit mësimor në shkolla dhe drejtorët caktohen në baza partiake. Kjo është më tepër se sa politizim i shkollës.

Problemi i katërt, ka të bëjë me statusin e arsimtarit. Nuk ka shkollë të suksesshme me një leadership të dobët. Nëse dëshirojmë të kemi arsim modern, arsimtari duhet ta ketë një pozitë të definuar. Nuk mund të ketë kualitet në arsim me paga lineare. Apeloj që të mos ketë rritje prej 10%, por pagat e arsimtarëve të rriten 100%.

Problemi i pestë, ka të bëjë me braktisjen e shkollës. Sipas raportit të Ministrisë gjatë vitit 2004/2005 shkollën e kanë braktisur 4.141 nxënës, prej tyre 47% janë meshkuj e 53% janë vajza.

Prandaj, me qëllim të tejkalimit të kësaj gjendje i propozoj Kuvendit që t'i miratojë këto rekomandime:

1. Gjysma e suficitit buxhetor, nga viti i kaluar, të përdoret për ndërtimin e shkollave të reja dhe për renovimin e të vjetrave;
2. Të ngritet cilësia në arsim, sidomos për lëndët e matematikës, gjuhës angleze dhe gjuhës amtare;
3. Të definohet qartë statusi i arsimtarit si nëpunës shtetëror, paga e të cilit do të duhej të rritej 100% dhe kjo rritje të jetë në progresion dhe
4. Të rritet numri i studentëve që do të regjistrohen këtë vit në Universitetin e Prishtinës.

Kryetari e ftoi ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë ta merrte fjalën.

Ministri **Agim Veliu** — Ka disa vite që arsimi parauniversitar ka kaluar nga faza emergjente në fazën zhvillimore. Prandaj edhe po ballafaqohet me të gjitha sfidat që janë tipike për një shoqëri në tranzicion.

Meqë gjatë këtyre 8 vjetëve kemi marrë një përgjegjësi të përbashkët për ndërtimin e institucioneve në Kosovë, fokusi i parë i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka qenë dhe mbetet ndërtimi i kapaciteteve menaxhuese të sistemit arsimor. Në këtë drejtim i

kemi kushtuar kujdes të veçantë kompletimit të infrastrukturës ligjore dhe ndërtimit të mekanizmave për jetësimin e saj.

Para dy javësh Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë e arsimit parauniversitar 2007/2017, dokumentin që skicon rrugën e zhvillimit të këtij sektori në të ardhmen.

Një pjesë e masave ka të bëjë me sigurimin e një menaxhimi cilësor dhe efikas në sistemin e arsimit, që nënkupton angazhimin e mëtutjeshëm në hartimin e legjislacionit në harmoni me normat e Bashkimit Evropian, profesionalizimin e udhëheqjes arsimore në të gjitha nivelet përmes programeve aftësuese, ndërtimin e një infrastrukture të përpunimit të të dhënave në arsim, delegimin më të madh të kompetencave dhe të përgjegjësi në nivel shkolle etj.

Pra, duhet të mësohemi t'i rishikojmë dhe t'i plotësojmë kurikulat, tekstet mësimore, programet e trajnimit duke ndërtuar kështu një sistem për sigurimin e cilësisë.

Koha e sotme vërtet kërkon një gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim të diversitetit në arsim. Para disa vitesh kemi pasë një numër relativisht të madh të fëmijëve që kanë braktisur shkollimin e obligueshëm dhe një numër edhe më të madh të atyre që nuk kanë qenë në gjendje ta vazhdojnë shkollimin e mesëm.

Në këtë fushë problemet arsimore ndërlidhen me probleme sociale, por edhe me probleme të natyrave të tjera. Të gjitha familjet në Kosovë nuk mund t'i përballojnë shpenzimet për shkollimin e fëmijëve të tyre. Ndërkaq, te disa komunitete pakicë, në veçanti te romët, aashkalinjtë dhe egjiptasit shkalla e pjesëmarrjes në arsim vazhdon të jetë i ulët.

Pastaj i kemi fëmijët me nevoja të veçanta për të cilët në çdo komunë në Kosovë janë hapur të ashtuquajturat paralele të bashkangjitura, me qëllim që ata të mos izoloohen në shkolla speciale.

Lëvizje demografike dhe shkatërrimet e luftës kanë bërë që ne sot të kemi shkolla të stërngarkuara edhe me tri ndërra në zona urbane dhe gjysmë të zbrasta në disa zona rurale. Për momentin në shkollat e Kosovës ka rreth 2.5 metra katrorë për nxënës, që përmbush vetëm gjysmën e nevojave, ndërkohë që 30% të hapësirës shkollore ekzistuese ka nevojë për rinovime urgjente gjatë periudhës vijuese 5- vjeçare.

Gjendja ekzistuese imponon që të angazhohemi për përmbushjen e nevojave të ndryshme të shkollave, duke filluar nga siguri i ujit të pijshëm e deri te siguri i teknologjisë informative dhe qasjes në internet.

Të gjitha nevojat e sektorit të arsimit parauniversitar i përballojmë me një buxhet prej 99 milion euro, që paraqet rreth 4.2% të bruto produktit vendor.

Strategjia e arsimit parauniversitar parasheh rritjen e buxhetit për arsimin parauniversitar deri në 133 milion euro në vit brenda periudhës 2008/2012.

Qeveria e Kosovës dhe Ministria që unë e drejtoj janë të përkushtuar që të bëhen lëvizje në drejtim të përmirësimit të pozitës materiale të mësimdhënësve.

Ministria e shikon arsimin, jo si shpenzim, por si një investim në të ardhmen. Prandaj, është me rëndësi që reformat në arsim të mbështeten nga të gjithë sektorët e Qeverisë, por edhe nga Kuvendi.

Pastaj, **kryetari** e hapi debatin për gjendjen në arsimin fillor dhe të mesëm.

Në emër të grupeve parlamentare diskutuan: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së **Nimon Alimusaj**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Sala Ahmeti**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Myrvete Dreshaj**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Genc Gorani**, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Numan Baliq**, në emër të Grupit Parlamentar 6 plus, **Xhezair Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi**, si dhe deputetët: **Alush Gashi**, **Jakup Krasniqi**, **Gjylshene Berisha**, **Saniye Aliaj**, **Remzije Nimani**, **Drita Statovci**, **Gani Koci**, **Xhelal Canziba**, **Hajredin Hyseni**, **Ferid Agani**, **Sabri Hamiti**, **Naxhije Doçi**, **Ymer Halimi**, **Ramë Buja**, **Ragip Zekolli**, **Kamber Kamberi**, **Nexhat Rexha**, **Qibrije Hoxha**, **Fetah Berisha**, **Hajredin Kuçi**, **Ilmi Ahmeti**, **Hatixhe Hoxha**, **Zef Morina**, **Ramadan Musliu**, **Mark Krasniqi**, **Tetuta Sahaqija**, **Nuran Malta**, **Xhevdet Neziraj**, **Ilaz Pireva**, **Bajrush Xhemajli**, **Ymer Muhaxheri**, **Jonuz Kastrati**, **Berat Luzha**, **Zylfije Hundozi**, **Fatmire Mulhaxha**, **Ibush Jonuzi**, **Nekibe Kelmendi**, **Zylfi Merxha**, **Rifat Krasniq** dhe **Sala Berisha-Shala**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, në emër të parashtruesit të mocionit për debat, **Enver Hoxhaj** tha se pas konsultimeve dhe marrëveshjes së arritur ndërmjet grupeve parlamentare Kuvendit i propozojmë t'i miratojmë këto

REKOMANDIME

1. Arsimi në Kosovë, jo vetëm ai fillor dhe i mesëm, të bëhet prioritet kombëtar dhe të përfshihet në programin e Qeverisë dhe në buxhetin e saj për vitin e ardhshëm;
2. Të rivlerësohen të gjitha ligjet, që janë miratuar në fushën e arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë, sa zbatohen ato dhe a janë në përputhje me realitetin në fushën e arsimit;
3. Të ngritët buxheti për arsimin, të ngritën pagat e arsimtarëve këtë vit (nga suficiti i buxhetit të vitit paraprak), të ketë ngritje të buxhetit për investimeve kapitale dhe për mallra dhe shërbime.

Kryetari i hodhi në votim rekomandimet e propozuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----68;

Kundër-----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, pasi debatoi për gjendjen e arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë, njëzëri i miratoi rekomandimet e harmonizuara nga grupet parlamentare.

8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri t'i arsyetonte rekomandimet para deputetëve të Kuvendit.

Ibush Jonuzi, kryetar i Komisionit shpjegoi procedurat e shqyrtimit dhe të intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës. Qeveria e Kosovës Kuvendit ia kishte propozuar dhjetë kandidatë, kurse Komisioni në pajtim me nenin 25 të Ligjit për konkurrencën, pas intervistimit të tyre, Kuvendit ia propozon pesë kandidatë, si vijon;

1. Remzije Hajdari, juriste e diplomuar,
2. Mustafë Hasani, ekonomist i diplomuar,
3. Denis Jonuzi, ekonomist i diplomuar,
4. Hysni Treziu, ekonomist i diplomuar dhe
5. Hydajet Hyseni, jurist i diplomuar.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e Rekomandimit për kandidatët e propozuar për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës.

Deputeti **Gazmend Muhaxheri** pati vërejtje për procedurat e punës së Komisionit, si dhe për prejardhjen e kandidatëve të propozuar, ngase të gjithë, sipas tij, janë nga rajoni i Gjilanit.

Deputeti **Berat Luzha** tha se Komisioni gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të këtij komisioni si kriter vlerësimi ka pasur përkatësin partiake.

Deputeti **Emrush Xhemajli** pati vërejtje në biografinë e njërit nga kandidatët e propozuar për anëtar të Komisionit të Konkurrencës.

Kryetari, në mungesë të kuorumit, seancën e deklaroi të mbyllur në orën 17:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale